Kronikë

Vrasja e Gentjan Bejtjas, identifikohet një nga ekzekutorët! Shpallet në kërkim ndërkombëtar 41-vjeçari nga Vlora me 3 identitete (EMRI)

Policia ka identifikuar një nga ekzekutorët e Gentian Bejtjas, i cili u ekzekutua me breshëri plumbash në mars të këtij viti në oborrin e banesës së tij në Larushk të Fushë-Krujës. Policia ka shpallur në kërkim ndërkombëtar një 41-vjeçar nga Vlora me 3 identitete

Gentian Bejtja (ma vonë Ku e vra

Redaksia
29 Gusht, 10:15 | **Përditësimi: 29 Gusht, 10:54**

Share

TIRANË- Më shumë se 5 muaj nga atentati mafiuz që ia të vdekur me breshëri plumbash ***Gentian Bejtjas***, në oborrin e banesës së tij Gentian Bejtjan, në Larushk të Fushë-Krujës, policia ka shpallur në kërkim ndërkombëtar një tjetër të dyshuar si ekzekutor i të 43-vjeçarit. Bëhet fjalë për një 41-vjeçar nga Vlora, Florian Plaku, i cili përdor edhe 2 mbiemra të tjerë.

Ndaj Florian Plakut, gjykata e Tiranës ka caktuar më 26 korrik masën e sigurisë 'arrest me burg' si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Vrasja me paramendim" kryer në bashkëpunim, dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit'.

Në lidhje me atentatit ndaj Gentian Bejtjas, vetëm pak ditë pas ekzekutimit të tij më 19 mars, policia arrestoi në flagrancë **Ilir Beqaraj** alias Ilir Brahimi, alias Ilir Mançellari, 41 vjeç dhe Edison Haxhiun, 30 vjeç.

LEXO EDHE:
U ekzekutua në Athinë, Roan Brahimi dyshohet si financues i atentatit ndaj Gentjan Bejtjas në Fushë Krujë! Lidhja me një prej të arrestuarve

Në vijim të njoftimit të njajasjes së datës 15.03.2024, për vrasjen e shtetasit Gentjan Bejtja, brenda rrethimit të oborrit të banesë së tij, në fshatin Larushkë, Krujë, ju informojmë si më poshtë:

Për hetimin e kësaj njajasje të rëndë kriminale, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ka ngritur menjëherë një grup të posaçëm hetimor, i cili në drejtimin profesional të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka kryer në vijimësi të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, me iniciativë apo të urdhëruar nga Prokurori.

Lidhur me këtë njajasje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është regjistruar procedimi penal nr. 1944 të vitit 2024, për veprat penale "Vrasja me paramendim" kryer në bashkëpunim, dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 78, 25 dhe 278/1 të Kodit Penal.

Nga tërësia e veprimeve të thëllusara hetimore ka rezultuar se autorët janë afruar tek banesa e shtetasit Gentjan Bejtja me automjetin e markës "Land Rover Discover" me ngjyrë të zezë dhe pas kryerjes të vrasjes, po me këtë automjet janë larguar në aksin rrugor Larushkë - Thumanë, pas kalimit të mbikalimit të Fushë Krujës, janë khtyer majtas dhe në fshatin Hasan kanë djegur automjetin e mësipërm.

Nga kryerja e veprimeve hetimore është vërtetuar se autorët janë larguar me një automjet tip "Volksëagen Golf" me ngjyrë të zezë, pa targë në jpesën e pasme, duke ndjekur intinerarin nga vendi i djegjes së automjetit në drejtim të rrugës kryesore Thumanë-Fushë Krujë, kanë devijuar djathtas në mbikalimin e Fushë-Krujës dhe janë larguar në drejtim të fshatit Bubq, Krujë.

*Nga analiza e informacioneve të marra nga inteligjenca policore si dhe kërqyrja dhe marrja e kamerave të sigurisë, është bërë i mundur identifikimi i automjetit tip "Volksëagen Golf" me targë AB960GG, në pronësi të shtetasit **Edison Haxhiu**, 30 vjeç, lindur në Milot, Kurbin dhe banues në Tiranë. Po kështu, ka rezultuar se ky automjet është përdorur edhe nga shtetasi Ilir Beqaraj alias Ilir Brahimi alias Ilir Mançellari, lindur në Milot, Kurbin dhe banues në Tiranë.*

Më datë 19.03.2024, strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë bëtë të mundur gjetjen dhe sekuestrimin e automjetit tip "Volksëagen Golf" me ngjyrë të zezë me targë AB960GG në pronësi të shtetasit Edison Haxhiu dhe shoqërimin në ambjentet e Policisë. Gjithashtu, në vazhdim të veprimeve hetimore, po në këtë datë u bë i mundur shoqërimi në ambjentet e Policisë i shtetasit Ilir Beqaraj alias Ilir Brahimi alias Ilir Mançellari.

Gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Ilir Beqaraj alias Ilir Brahimi alias Ilir Mançellari janë gjetur dhe sekuestruar, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë me mbushëkrimin "Eather" me tetë fishekë, një armë zjarri e markës "Benelli", e cila mbajtëse me lejen e organeve të Policisë, një breç me njëzet e nëntë fishekë arme zjarri, pesë pajisje si ato të radiove marrëse-dhënëse, një pasaportë e Republikës të Kosovës në emër të shtetasit Kosovar B. A., e dyshuar e falsifikuar pasi fotografia është e ngjashme me fotografinë e shtetasit Ilir Beqaraj alias Ilir Brahimi alias Ilir Mançellari, një kartë identiteti e Republikës të Kosovës në emër të shtetasit Kosovar B. A., e dyshuar e falsifikuar pasi fotografia është e ngjashme me fotografinë e shtetasit Ilir Beqaraj alias Ilir Brahimi alias Ilir Mançellari, dhe 2 aparate celulare.

Më datë 19.03.2024, nga Sektori për Hetimin e Krimeve të Rënda në DVP Tiranë është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit Ilir Beqaraj alias Ilir Brahimi, alias Ilir Mançellari, 41 vjeç, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe e municionit", dhe "Falsifikimi i dokumentave" parashikuar nga nenet 278/2 dhe 186 të Kodit Penal, si dhe ndalimi i shtetasit Edion Haxhiu, 30 vjeç, për veprën penale "Sigurimi i kushte dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje", parashikuar nga neni 80 i Kodit Penal.

Në vijim të kryerjes së veprimeve të thëllusara hetimore, shfryetëzimit të inteligjencës policore, administrimit të provave dhe ekzaminimeve të ndryshëme kriminalistike, administrimit të dokumentave, grupi i posaçëm hetimor në drejtimin e Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka bërë të mundur dokumentimin ligjor të implikimit të personave të njëre si autorë të kësaj njajasje

Në vlerësim të provave dhe fakteve, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1885 datë 26.07.2024 ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg", në mungesë, ndaj shtetasit F. P., alias F. S., alias F. M., 41 vjeç, lindur dhe banues në Vlorë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Vrasja me paramendim" kryer në bashkëpunim, dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 78, 25 dhe 278/1 të Kodit Penal.

Shërbimet e DVP Tiranë, të mbështetura në fazën operacionale nga shërbimet e DVP Vlorë, kanë ushtruar kontrolle për lokalizimin e shtetasit F. P., alias F. S., alias F. M., 41 vjeç, dhe vijon puna për kapjen e këtij shtetasi i cili është shpallur në kërkim ndërkombëtar.

Gjithashtu, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithëm Tiranë, është ushtruar kontroll në ambjentet e një agensie udhëtimesh në qytetin e Lezhës, ku janë administruar pajisje elektronike dhe dokumente me vlerë për hetimin.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në vlerësim të provave dhe fakteve të administruara, ka bërë rikualifikimin e veprës penale në njarkim të shtetasit Ilir Beqaraj alias Ilir Brahimi alias Ilir Mançellari, dhe përveç veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", parashikuar nga nenet 186 dhe 278/1 të Kodit Penal, këtij shtetasi i është shtuar vepra penale "Vrasja me paramendim", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78 e 22 të Kodit Penal.

Hetimet vazhdojnë për identifikimin e autorëve të tjerë dhe për rezultatet e tyre do t'ju informojmë në vazhdimësi.'- njofton policia.

Lajmi në përditësim...

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Ilir Beqaraj | Edison Haxhiu | atentat gentian bejtjas | gentian bejtja

Komento

Ndalohet reklamimi i duhanit dhe produkteve të tij, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:
Skandali me mbetjet toksike, sipas jush e kujt është përgjegjësia?

Kurum | Koncesionari | Shteti

Lajme të tjera

Atentati ndaj Gentian Bejtjes, bie poshtë pretendimi i 2 të arrestuarve! Në makinë nuk kishte GPS, atentatorët me dy mjete deri pranë vilës

Sokol Dema

18 Dhj, 11:16

Vrasja e Gentian Bejtjas në Fushë-Krujë, Apeli lë në burg Edison Haxhiun dhe Ilir Beqarajn

9 Prill, 17:29

Eksskluzive/ 'Frontline' rindërton skenën e atentatit ndaj Gentian Bejtjas në Fushë Krujë (Video)

21 Mars, 21:21

Vrasja e Bejtjas, rolet e 2 të arrestuarve! Ilir Beqaraj transportoi 4 ekzekutorët, i mori pasi dogjën mjetin e krimit! Lihen të 2 në burg

Sokol Dema

21 Mars, 13:42

Vrasja e Gentian Bejtjas, Fushë Kruja e rrethinat në 'shtet rrethim', FNSh kontrolle të befasishme në mjete të dyshimta (Video)

20 Mars, 20:53

Ekzekutimi i Gentian Bejtjas, një prej të arrestuarve kushëriri i Ylli Brahimit, krahut të djathtë të Ervis Martinajt

20 Mars, 11:38

Vrasja e Gentian Bejtjas, arrestohet një prej autorëve! Në pranga edhe pronari i mjetit me të cilin u larguan ekzekutorët nga Fushë Krujë! Detajë që i zbuloi

20 Mars, 10:18

Fushë Krujë/ Ekzekutimi i Gentjan Bejtjas, plumba dhe në gjshtat e këmbëve! Kërkohen të pyeten dhe anëtarë të fisit Bami

19 Mars, 11:46

Atentati ndaj Gentian Bejtjas, gazetari Dema: Janë mbi 25 të shoqëruar, 'të fortë' të zonës! Eksperti Softa: 3 qitës me kallashnikov qëlluan ndaj tij

18 Mars, 17:21

Pas vrasjes së Gentian Bejtjas, policia e FNSH aksion 'blic' në Fushë Krujë! Kontrolle makinave luksoze dhe me shama të zinj edhe në Vlorë

16 Mars, 20:08

Atentati ndaj Gentian Bejtjas, eksperti Softa për Report Tv: Ekzekutorët e vëzhguan me kamera, vrasje me pagesë

16 Mars, 19:43

Atentati në Fushë-Krujë, Gentian Bejtja u ekzekutua me 30 plumba, u qëllua nga afër! Atentatorët me 'Land Rover' targat u vodhën në Shkodër

16 Mars, 09:31

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pjaustorizuar i kesaj faqeje